Rrjeti i Aftësisë Ripërtëritëse (Qëndrueshmërisë) së Komunitetit në nivel lokal është një rrjet joformal që luan një rol të rëndësishëm në rritjen e gatishmërisë dhe në realizimin e një përgjigje sa më efektive ndaj emergjencave shëndetësore. Ai është një rrjet për shërbimin ndaj komunitetit para, gjatë dhe pas emergjencave shëndetësore. Ky rrjet bashkon aktorë të ndryshëm, burime dhe ekspertizë brenda një komuniteti për të trajtuar në mënyrë efektive një gamë të gjërë rreziqesh shëndetësore, duke përfshirë epidemitë, pandemitë, fatkeqësitë e ndryshme natyrore, shpërthimet e sëmundjeve dhe emergjenca të tjera. Duke nxitur bashkëpunimin, koordinimin dhe komunikimin ndërmjet aktorëve të ndryshëm, Rrjeti i Aftësisë Ripërtëritëse (Qëndrueshmërisë) së Komunitetit synon të krijojë një bazë të fortë për forcimin e gatishmërisë së komunitetit, reagimin e shpejtë në raste emergjencash shëndetësore dhe rimëkëmbjen e qëndrueshme përballë sfidave të papritura shëndetësore

Në qendër të Rrjetit të Aftësisë Ripërtëritëse (Qëndrueshmërisë) së Komunitetit janë individët, organizatat dhe institucionet që janë thellësisht të përkushtuara për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqënien e anëtarëve të komunitetit të tyre.

Çfarë janë CRN?

Përfaqësimi në këtë rrjet i sa më shumë strukturave, organizatave/shoqatave, grupeve të ndryshme që nuk përfaqësohen tradicionalisht në komisionet e mbrojtjes civile, apo në struktura të përgjigjes apo të rehabilitimit dhe rimëkëmbjes nga emergjencat shëndetësore apo nga fatkeqësitë e ndryshme pasojë e të cilave mund të jenë emergjencat shëndetësore është mbajtur në konsideratë gjatë krijimit të këtij rrjeti. Institucionet dhe strukturat e qeverisjes vendore, ofruesit e kujdesit shëndetësor, strukturat e përgjigjes ose të reagimit ndaj emergjencave, grupet me bazë në komunitet, individët, shkollat, bizneset dhe organizatat me bazë besimi, të gjithë luajnë një rol të rëndësishëm në aftësitë, kapacitetet dhe burimet e rrjetit

Nëpërmjet përpjekjeve dhe përgjegjësive të përbashkëta, këto palë të interesuara punojnë së bashku për të vlerësuar nevojat dhe risqet, për të formuluar objektiva dhe qëllime, për të zhvilluar plane veprimi, për të ndërtuar kapacitete dhe burime dhe për të zbatuar mekanizmat monitorues për të siguruar efektivitetin dhe efikasitetin e gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave shëndetësore.
Në periudhë emergjencash apo fatkeqësish, Rrjeti i Aftësisë Ripërtëritëse (Qëndrueshmërisë) së Komunitetit vepron si një front i bashkuar me strukturat e tjera vepruese për menaxhimin e situatës, duke kontribuar me shpejtësi me burimet, njohuritë dhe mbështetjen për të përballuar emergjencat shëndetësore në një mënyrë të koordinuar dhe bashkëpunuese në mënyrë që të shpëtohen jetë njerëzish dhe impakti i tyre të jetë sa më i ulët.
Përvoja tregon se pjesëmarrja aktive e komuniteteve ka një rol kyç për sa i takon kontrollit dhe shpërthimeve të epidemive, pandemive dhe në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve në emergjencat shëndetësore. Pandemia COVID-19 ka rritur rëndësinë e angazhimit të komunitetit në mbështetjen e masave të ndryshme shëndetësore, publike dhe sociale të ndërmarra për menaxhimin e tij.



Si janë formuar CRN-të?



Rrjeti i Aftësisë Ripërtëritëse dhe Qëndrueshmërisë së Komunitetit (CRN), është një rrjet në nivel lokal të Njësisë Administrative ose Bashkisë. Gjatë vitit të parë dhe të dytë të implementimit të projektit SOLIDAR-Bashkë në emergjencat shëndetësore, janë ngritur 5 rrjete CRN, përkatësisht në Bashkinë e Pukës, në Njësinë Administrative Dajç-Bregu i Bunës, Njësinë Administrative Fushë-Krujë, Bashkinë Gramsh dhe Bashkinë Përmet.

Ngritja dhe formimi i tyre mund të themi që ka qenë sfidues, duke qenë se është një grup që funksionon në baza totalisht vullnetare, por e ka paraprirë një proces hartëzimi i aktorëve lokal dhe grupeve të interesit që veprojnë në territoret ku janë ngritur këto rrjete. Më pas është bërë një vlerësim i cënueshmërive dhe problematikave të zonave, të cilat janë burime të mundshme të emergjencave civile dhe natyrore e rrjedhimisht dhe atyre shëndetësore. Duke marrë parasysh që grupet e cënsueshme të përfaqësohen në këtë rrjet, u ftuan anëtarë të ndryshëm të komunitetit, përfaqësues të organizatave lokale, profesionistë të shëndetit dhe ofrues të shërbimeve në nivel lokal.

Çdo CRN ka një përbërje prej 15-20 personash, diku dhe më shumë, por pavarsisht këtij numri, në çdo rrjet është një grup më i vogël që është më i qëndrueshëm dhe më aktiv, që kryesisht angazhohet më shumë në iniciativa që kanë ndërmarrë, në trajnime dhe aktivitete për të rritur kapacitetet e tyre si grup.

CRN Gramsh

CRN e Gramshit ka një përbërje prej 24 anëtarësh, të cilët kanë marrë përsipër angazhimin për të qenë pjesë e këtij rrjeti. Përbërja e këtij rrjeti është mikse me përfaqësues të komunitetit, përfaqësues nga sektori i shëndetësisë si infermierë dhe mjek, jo vetëm të qytetit të Gramshit, por dhe të QSH në fshatrat përreth, me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të Bashkisë, nga sektori i arsimit, nga organizata të shoqërisë civile si Kryqi i Kuq, përfaqësues të komuniteteve fetare, studentë. Ky rrjet ka zgjedhur dhe grupin drejtues të tyre, të cilët luajnë një rol shumë të madh në organizimin e këtij rrjeti.
Të gjithë përfaqësuesit e rrjetit janë individë me besueshmëri në komunitet dhe kjo është shumë e rëndësishme për rrjetin që të funksionojë. Tashmë është një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë e Gramshit dhe rrjetit të CRN, me mbështetjen e organizatës Together for Life në kuadër të projektit SOLIDAR-Bashkë në emergjencat shëndetësore. Kjo marrveshje është vendosur dhe lehtësuar nga vetë përfaqësuesit e grupit drejtues të CRN Gramsh. Kjo është një arritje e këtij rrjeti, sepse kjo marrveshje jo vetëm lehtëson veprimtarinë e grupit të CRN, por gjithashtu është një formë drejt njohjes dhe formalizimit të këtij rrjeti.
Përtej kësaj, ky rrjet ka ndërmarrë një nisëm tjetër advokacie, e cila është e përshkruar më poshtë, si një rast suksesi i veprimtarisë së CRN-së.

Iniciativa

Vendosja e tabelave informuese në zonat e rrezikshme të Liqenit të Banjës – Gramsh

Përshkrimi i shkurtër

Anëtarët e komunitetit, në bashkëpunim me CRN, ngritën si shqetësim rrezikun e mbytjes në disa zona të liqenit të Banjës, ku thellësitë dhe gropat kanë shkaktuar aksidente fatale. Për të mbrojtur jetën e qytetarëve, iu kërkua Bashkisë Gramsh të vendosë tabela paralajmëruese dhe të ndërmarrë masa parandaluese.

Qëllimi dhe objektivat

- Parandalimi i aksidenteve dhe ruajtja e jetës së qytetarëve.
- Vendosja e tabelave paralajmëruese dhe rritja e ndërgjegjësimit mbi rreziqet.
- Forcimi i partneritetit mes komunitetit, CRN dhe Bashkisë për sigurinë publike

CRN Gramsh

Grupi i synuar

Banorë të zonës, pushues e turistë, nxënës dhe të rinj, si edhe anëtarë të CRN-së e institucione vendore.

Aktivitetet kryesore

- Identifikimi i pikave më të rrezikshme dhe konsultimi me ekspertë.
- Vendosja e tabelave paralajmëruese dhe organizimi i fushatave sensibilizuese.
- Takime komunitet–institucione dhe krijimi i një grupi pune lokal për sigurinë.



Rezultatet e arritura

- Shënimi i zonave kritike dhe vendosja e tabela informuese, duke ulur ndjeshëm rrezikun e mbytjes.
- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe turistëve mbi sigurinë në ujë.
- Krijim i një model bashkëpunimi i qëndrueshëm mes CRN, bashkisë dhe komunitetit

Përshtypje nga pjesëmarrësit

“Shumë aksidente mund shmangen falë informimit nga tabelat.”
“Ky ishte një shqetësim i madh për komunitetin tonë; tani ndihemi pak më të sigurt.”

Pse është praktikë pozitive?

Kjo nismë është një praktikë e mirë sepse parandalon humbjen e jetëve me kosto të ulët, mbështetet në përvojën e komunitetit dhe forcon partneritetet lokale. Ajo tregon se masat parandaluese të thjeshta, të bazuara në përfshirjen e qytetarëve, kanë ndikim të madh dhe mund të përsëriten në zona të tjera me rrezik të ngjashëm.

CRN Përmet

CRN e Bashkisë Përmet është e përbërë nga 30 anëtarë të regjistruar dhe angazhuar për tu bërë pjesë e këtij rrjeti. Edhe pse jo të gjithë janë aktivë në të gjithë aktivitetet dhe nismat që ndërmarrin si rrjet, është pozitive që kanë një grup bërthamë të konsoliduar që marrin pjesë në takime dhe janë aktivë. Pjesë e këtij rrjeti janë disa anëtarë të komunitetit, kryesisht mosha e tretë, ka infermiere nga sektori i shëndetësisë, përfaqësues nga sektori i shërbimeve sociale në Bashki, përfaqësues nga Njësi Administrative, përfaqësues nga sektori i arsimit, shoqeria civile, etj.
Në drejtim të këtij grupi janë zgjedhur dy bashkë-drejtuese të cilat angazhohen për të mobilizuar grupin, me ndihmën dhe të kordinatores lokale.
Edhe me këtë rrjet, tashmë është vendosur një marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë e Përmetit dhe rrjetit të CRN, me mbështetjen e organizatës Together for Life në kuadër të projektit SOLIDAR-Bashkë në emergjencat shëndetësore. Kjo marrveshje është vendosur dhe facilituar nga vetë përfaqësuesit e rrjetit, të cilët janë të motivuar për tu angazhuar dhe për të sjellë ndryshime të nevojshme në përmbushje të nevojave të komunitetit, sidomos të grupeve vulnerabël, në marrjen e shërbimeve shëndetësore dhe për të advokuar që të merren në mënyrë cilësore.
Që në fillim të krijimit dhe funskionimit të këtij rrjeti, ata janë angazhuar në nisma advokacie, duke kërkuar përmirësimin e shërbimit të Laboratorit të Analizave në Spitalin Bashkiak të Përmetit, për tu pajisur me reagentë dhe paisje të nevojshme, që kryerja e analizave për pacientët të jetë i plotë dhe cilësor. Ky proces advokimi është akoma në vazhdimësi, pas komunikimeve zyrtare me institucionet përkatëse. Këtu do të paraqesim një tjetër praktikë pozitive të realizuar nga rrjeti CRN Përmet që tregon një prej funksioneve të këtij rrjeti.

Iniciativa

Trajnim dhe simulim për ndihmën e parë në emergjenca shëndetësore në fshatin Sukë-Përmet

Përshkrimi i shkurtër

Një trajnim u organizua në kuadër të veprimtarisë së CRN, ku anëtarët e CRN-së së Përmetit u trajnuan nga mjekë të specializuar mbi dhënien e ndihmës së parë në raste emergjencash shëndetësore. Në vijim, më 24 prill, një prej anëtareve të CRN-së e replikoi këtë iniciativë përmes organizimit të një sesioni informues me pjesë teorike, diskutime dhe ushtrime praktike, me nxënësit e Shkollës “Lumo Pavari” në fshatin Sukë.

Qëllimi dhe objektivat

- Rritja e gatishmërisë së komunitetit për të përballuar emergjenca shëndetësore.
- Njohja e procedurave bazë të ndihmës së parë.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe CRN-së.
- Ndërgjegjësimi i të rinjve për rëndësinë e përgatitjes ndaj emergjencave.

CRN Përmet

Grupi i synuar

Nxënës të shkollës (klasa e X dhe XI)
Stafi drejtues i shkollës “Lumo Pavari”, drejtori dhe nën/drejtori, mësues.

Aktivitetet kryesore

- Prezantimi i programit Solidar dhe Rrjetit CRN- Përmet
- Shpjegime teorike me ndihmën e një prezantimi PowerPoint për situatat e emergjencave shëndetësore.
- Ushtrime praktike me simulim të rasteve emergjente.
- Diskutime dhe pyetje-përgjigje me pjesëmarrësit.



Rezultatet e arritura

- Rritje e njohurive dhe aftësive praktike të pjesëmarrësve për ndihmën e parë.
- Përfshirja aktive e të rinjve dhe stafit shkollor.
- Forcimi i lidhjeve ndërmjet komunitetit dhe CRN-së.
- Ndërgjegjësim i shtuar për rëndësinë e gatishmërisë ndaj emergjencave.

Përshtypje nga pjesëmarrësit

“*Isha shumë e kënaqur me trajnimin. Tani ndihem më e sigurt se mund të ndihmoj në rast emergjence. Trajnime te tilla na nevojten sa më shumë në jetën tonë brenda dhe jashtë shkollës”.*

Pse është praktikë pozitive?

Kjo iniciativë është një shembull i mirë i përhapjes së njohurive nga ana e të trajnuarve drejt komunitetit, duke përfshirë breza të ndryshëm. Është e replikueshme dhe mund të përshtatet lehtësisht nga grupe të tjera CRN-sh në vende të tjera, duke nisur nga shkollat dhe duke u zgjeruar në komunitete të tjera

CRN Fushë-Krujë

CRN në Fushë Krujë është e përbërë nga 18 anëtarë fillimisht, por që nga fillesa janë bashkuar dhe anëtarë të tjerë. Edhe pse Fushë-Kruja është një komunitet miks, ky grup është shumë kompakt dhe i drejtuar nga dëshira për të marrë iniciativa për komunitetin, sidomos për ato që janë më vulnerabël. Rrjeti i CRN Fushë-Krujë është i përbërë nga përfaqësues të shkollës 9 vjecare me numrin më të madh të nxënësve në Shqipëri me 1600 nxënës dhe një staf prej 70 mësuesish, gjitashtu pjesë e rrjetit janë pjestarë të komunitetit Rom, përfaqësues të shoqërisë civile që gjithashtu punojnë për fuqizimin e komunitetit, përfaqësues të shërbimeve psiko-sociale dhe të shërbimeve shëndetësore, si dhe nga OSHKSH Krujë, përfaqësues të moshës së tretë, të rinj, etj. Ky grup është shumë aktiv në iniciativa të ndryshme që kanë të bëjnë me informimin e komunitetit, por dhe me cështje advokimi. Një prej cështjeve që ka rezultuar positive, është dhe iniciativa që ka ndërmarrë ky rrjet, në bashkëpunim me përfaqësues të shërbimeve shëndetësore për të sjellë një paisje Mamografie të lëvizshme për kontrollin e hershëm të grave.

Iniciativa

Depistimi i kancerit të gjirit për gratë e komunitetit të Fushë-Krujës përmes Mamografisë së lëvizshme

Përshkrimi i shkurtër

Disa anëtare të grupit të CRN-së në Fushë-Krujë organizuan një iniciativë të rëndësishme për shëndetin e grave, duke mundësuar ofrimin e mamografisë së lëvizshme. Kjo nismë kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe aksesit në shërbime parandaluese, veçanërisht për gratë që kanë më pak mundësi për të kryer kontrolle të rregullta shëndetësore. Organizimi u bë i mundur përmes bashkëpunimit të stafit mjekësor, përfaqësuesve të organizatave partnere, dhe anëtarëve të vetë grupit CRN, të cilët luajtën një rol kyç në mobilizimin e komunitetit dhe informimin mbi rëndësinë e kontrollit të hershëm.

Qëllimi dhe objektivat

- Promovimi i shëndetit të grave përmes depistimit të hershëm të kancerit të gjirit.
- Rritja e ndërgjegjësimit në komunitet mbi rëndësinë e kontrolleve të rregullta dhe të parandalimit të sëmundjeve malinje.
- Përmirësimi i aksesit në shërbime shëndetësore për gratë në zona më pak të mbuluara me kujdes mjekësor.
- Fuqizimi i grave për të marrë rol aktiv në kujdesin ndaj shëndetit të tyre.
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve lokalë, përfshirë organizatat, institucionet shëndetësore, komunitetin dhe grupin e CRN-së.

CRN Fushë-Krujë

Grupi i synuar

Rreth 50 gra të zonës së Fushë-Krujës të cilat nuk kishin kryer ndonjëherë mamografi.
Gratë e komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Fushë Krujës



Aktivitetet kryesore

- Sesione informuese
- Shpërndarje fletëpalosje/ broshura me informacion mbi vetë kontrollin e gjirit dhe masat parandaluese të kancerit të gjirit
- Mamografi pranë stacionit të lëvizshëm të vendosur jashtë qendrës shëndetësore.

Rezultatet e arritura

- Disa nga anëtarët e CRN-së evidentuan një shërbim të munguar dhe të domosdoshëm për grate e komunitetit.
- CRN ndërmori nismën dhe kontaktuan personat përgjegjës për dërgimin e mamografisë së lëvizshme në Fushë Krujë.
- Grupi i CRN-së bashkëpunoi me qendrën shëndetësore për të organizuar dhe sesione informuese.
- Kjo nismë nxiti diskutimet për të ndërmarrë nisma të tjera në lidhje me shëndetin dhe mirëqënien në të ardhmen.

Përshtypje nga pjesëmarrësit

"Ishte një shërbim që mungon në komunitetin ku jetojmë. Eshtë një gjë shumë e mirë që shërbimi mund të vije këtu ku jemi ne."

Pse është praktikë pozitive?

Kjo nismë adreson një nevojë reale dhe të menjëhershme të evidentuar nga disa prej anëtarëve të CRN-së, duke përfshirë komunitetin lokal dhe aktorë të ndryshëm me fokus tek shëndeti dhe mirëqenia e qytetarëve. Ajo përbën një model të thjeshtë e efektiv, i cili mund të replikohet lehtësisht edhe nga CRN-të e tjera, pasi nuk është i kufizuar vetëm në zonën e Fushë Krujës.

CRN Dajç

CRN e Dajcçt është e përbërë nga 27 pjestarë të cilët janë anëtarë të komunitetit si kryetarë fshatrash, përfaqësues nga Njësia Administrative, mjeku dhe infermierë të QSH, mësues dhe përfaqësues të shoqërisë civile që punojnë në zonë në një qendër komunitare që është e ngritur, blektorë dhe fermerë. Edhe ky rrjet është kompakt, kryesisht grupi kryesor që merr pjesë aktivisht në takimet dhe iniciativat që ndërmerr. Në bashkëpunim dhe me organizatën D&E që operon në zonë nëpërmjet Qendrës Komunitare, rrjeti ka realizuar disa iniciativa informimi dhe ndërgjegjësimi me komunitetin, me grup pacientësh, me fëmijë dhe të rinj. Gjithashtu, një nismë advokacie e iniciuar nga ky rrjet, është dhe kërkesa për të vënë në përdorim një autoambulancë e cila u është bërë dhuratë nga dipaspora.

Iniciativa

Angazhimi i anëtarëve të CRN-së në procedura advokimi për përdorimin e autoambulancës nga QSH Dajc

Përshkrimi i shkurtër

Anëtarët e CRN-së Dajç kanë ndërmarrë një sërë veprimtarish advokuese për vënien në përdorim të autoambulancës së dhuruar nga komuniteti për qendrën shëndetësore, duke e ngritur çështjen në dëgjesat publike të Bashkisë Shkodër dhe duke kërkuar zgjidhje për ngërçin ligjor mbi përdorimin e saj. Drejtori i QSH ka bërë kërkesa të përsëritura për sigurimin e një shoferi autoambulance, ndërsa me mbështetjen e ekspertizës së TFL janë ndjekur procedurat për orientimin e grupit drejt një zgjidhjeje të mundshme. Një shembull i mirë i bashkëpunimit është përfshirja e CRN-së në ditën e projekteve të shkollës së mesme të bashkuar të Dajçit, duke treguar se rrjeti është shndërruar në një model bashkëpunimi e ndarjeje informacioni që shkon përtej emergjencave shëndetësore

Qëllimi dhe objektivat

- Vënia në përdorim të autoambulancës për komunitetin e Dajçit
- Përgjigje ndaj nevojave të komunitetit për emergjencat shëndetësore
- Zgjerimi i bashkëpunimit dhe komunikimit të anëtarëve të rrjetit përtej tematikës së emergjencave civile por edhe nevojave të tjera komunitare.


CRN Dajç

Grupi i synuar

Anëtarë të CRN-së, ndër më aktivët: Drejtori QSH Dajç, Administratori i Nj.Ad Dajç, stafi i shërbimeve sociale në Nj.Ad Dajç, Dr. e shkollës bashkuar të Dajcit

Aktivitetet kryesore

- Ngritja e çështjes së autoambulancës në dëgjesat publike të Bashkisë Shkodër gjatë vitit 2024.
- Kërkesa nga drejtori i QSH pranë OSHKSH Shkodër.
- Takim mentorues nga TFL për ndjekjen e procedurave dhe orientimin e CRN-së drejt një zgjidhjeje ligjore të ngërçit.
- Përfshirja e anëtarëve të CRN-së në veprimtarinë e "Ditës së projekteve" të shkollës së mesme të bashkuar të Dajçit, duke zgjeruar bashkëpunimin edhe përtej emergjencave shëndetësore.



Rezultatet e arritura

- Janë prodhuar dokumente zyrtare të kërkesave nga mjeku i QSH-së Dajç drejtuar operatorit shëndetësor për vënien në përdorim të autoambulancës.
- Është realizuar kështillim ligjor mbi çështjen, dhe pritet një orientim profesional për hapat e mëtejshëm.
- Është forcuar bashkëpunimi dhe është zgjeruar përdorimi i rrjetit të CRN-së edhe për aktivitete përtej projektit.

Përshtypje nga pjesëmarrësit

"Përfshirja e organizatës tone D&E si anëtare e CRN-së Dajc na ka ndihmuar të kuptojmë më mirë dinamikat dhe vulnerabilitetin e komunitetit lokal"

Pse është praktikë pozitive?

Shembujt e lartpërmendur mund të merren si praktika të mira, duke treguar se një grup CRN-je mund të punojë dhe të kontribuojë në disa drejtime të ndryshme (advokim, zbatim projektesh, zgjerim i bashkëpunimit për çështje të tjera komunitare).

CRN Pukë

Community Resilience Network (CRN) Pukë përbëhet nga 29 anëtarë, të cilët përfaqësojnë struktura vendore, komunitetin, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë lokalë. Rrjeti është i konsoliduar dhe funksionon si një grup kompakt, me një pjesëmarrje aktive në takimet dhe trajnimet e zhvilluara për rritjen e kapaciteteve në fushën e emergjencave dhe shëndetësisë.
Si rrjet, ata kanë ndërmarrë disa nisma konkrete, duke demonstruar gatishmërinë për të kontribuar në forcimin e qëndrueshmërisë komunitare. Megjithatë, një nga sfidat kryesore mbetet rritja e angazhimit në informimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë, kryesisht për shkak të shpopullimit të zonës.
Anëtarët e CRN Pukë e vlerësojnë faktin që po punohet mbi një çështje kaq të rëndësishme si menaxhimi i emergjencave dhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore – fusha ku, deri më sot, asnjë nismë tjetër nga shoqëria civile apo aktorë të tjerë lokalë nuk ka pasur fokus kaq të drejtpërdrejtë.

Iniciativa

Siguri në komunitet

Përshkrimi i shkurtër

CRN Pukë, së bashku me aktivistë nga komuniteti, ka ndërmarrë një iniciativë për të kryer aktivitete advokuese në fushën e sigurisë komunitare. Kjo nismë ka lindur si përgjigje ndaj shqetësimeve të qytetarëve lidhur me pedonalen e qendrës së qytetit. Pedonaleja është realizuar me pllaka mermeri, të cilat janë shumë të papërshtatshme për Pukën, pasi gjatë dimrit, në temperaturat e ulëta, shtresa të holla akulli dhe reshjet e borës kanë shkaktuar aksidente rrëshqitjeje dhe dëmtime serioze në disa raste. Gjithashtu, gjatë verës, pllakat nën dritën e fortë të diellit janë verbuese dhe shumë të dëmshme për sytë.

Qëllimi dhe objektivat

- Nxjerrja në përparësi e masave nga Bashkia për përmirësimin e sigurisë dhe funksionalitetit të pedonales.
- Ndërhyrje konkrete për ristrukturimin e pedonales, duke shtuar elementë sigurie për kalimtarët.
- Ulja e numrit të aksidenteve gjatë ecjes në pedonale dhe rritja e sigurisë së qytetarëve.

CRN Pukë

Grupi i synuar

Banorë, anëtar të grupit CRN – së Pukë, përfaqësues nga pushteti vendor, të rinj etj.





Aktivitetet kryesore

- Organizimi i aktiviteteve informuese për qytetarët dhe aktorët lokalë.
- Takim me kryetarin dhe administratën e Bashkisë për të diskutuar shqetësimet e komunitetit.
- Përgatitja e një shkrese mbi problemet e shkaktuara nga pedonaleja dhe sugjerimet për përmirësim.

Rezultatet e arritura

- Është evidentuar qartë problematika e pedonales dhe ndikimi i saj në sigurinë e qytetarëve.
- Janë zhvilluar diskutime dhe janë hartuar rekomandime konkrete për ndërhyrje dhe përmirësimin e situatës.
- Është forcuar bashkëpunimi i mirë me institucionet lokale, duke krijuar një rrugë për zgjidhje të qëndrueshme të problemit.

Përshtypje nga pjesëmarrësit

"Është një ndërhyrje shumë me vend pasi disa qytetarë kanë pasur probleme me rrëshqitjet gjatë kohës së dimrit. Qytetarët kanë të drejtë të lëvizin të sigurtë në rrugët e qytetit"

Pse është praktikë pozitive?

Çdo iniciativë që përfshin komunitetin dhe merr vëmendjen e institucioneve lokale, duke rezultuar në zgjidhje konkrete të problemeve, konsiderohet e suksesshme dhe meriton të ndiqet. Kur të gjithë angazhohemi për gjetjen e zgjidhjeve, është e mundur të përmirësohen shumë aspekte të jetës në komunitet.

Qëndrueshmëria e CRN-ve

Rrjetet e Aftësisë Ripërtëritë të Komunitetit (CRN) të ngritura fillimisht në 5 zona në Shqipëri, në nivel Njësie Administrative dhe Bashkie, është një nismë e re dhe jo e hasur më parë, në lidhje me emergjencat shëndetësore dhe përtej tyre. Prezenca e rreziqeve të ndryshme, të cilat mund të shërbejnë si burime të emergjencave shëndetësore dhe civile e natyrore, në zona të ndryshme të Shqipërisë, mund të jenë të ndryshme dhe kush më mirë se njerëzit që jetojnë aty i njohin. Përbërja e një rrjeti të tillë me përfaqësues nga sektori shtetëror, privat, OJF dhe komuniteti, bën të mundur që të përfaqësojë interesat dhe nevojat e target gupeve të ndryshme, por gjithmonë duke patur në fokus ato që janë më të cënueshmit dhe më të pambrojturit.

Funskionimi dhe jetëgjatësia e qëndrueshmëria e një rrjeti të tillë, është në varësi të disa kushteve, të cilat aktualisht janë përmbushur disa prej tyre, por mbetet akoma punë për të realizuar të tjerat. Këto kushte janë:

1. **Hartimi dhe firmosja nga anëtarët e CRN-ve të dokumetit Korniza dhe Struktura gjithëpërfshirëse e Rrjetit të Aftësisë Ripërtëritëse** (qëndrueshmërisë, elasticitetit) së Komunitetit për gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj emergjencave shëndetësore në nivel lokal, Mekanizmat e funksionimit, Kanalet e komunikimit dhe Mekanizmat e koordinimit. Pjesa më e madhe e anëtarëve e ka firmosur këtë dokument, i cili nuk është detyrues dhe urdhërues, por është një bazë për funksionimin dhe veprimtarinë e këtyre rrjeteve. Çfarë mbetet për tu përmirësuar, është funskionimi i këtyre rrjeteve të ngritura tashmë, sipas kësaj kornize, duke nxitur takimet periodike dhe në kohë paqeje dhe hartimin e një plani konkret të përvitshëm dhe përpjekjet për ta realizuar në mënyrë të pavarur këtë plan.
2. **Njohja nga strukturat e pushtetit vendor për ekzistencën e një rrjeti të tillë**. Aktualisht janë firmosur marrëveshje bashkëpunimi me 4 Bashki, përkatësisht Bashkia Pukë, Bashkia Krujë, Bashkia Gramsh dhe Bashkia Përmet. Mbetet akoma për tu finalizuar marrëveshja me Bashkinë Shkodër. Në kuadër të kesaj marrëveshje, rrjeti CRN me mbështetjen e organizatës Together for Life, në kuadër të projektit SOLIDAR-Bashkë në emergjencat shëndetësore, ka një mbështetje nga pushteti vendor për të ushtruar veprimtarinë e saj në baza vullnetare.
3. **Fuqizimi që ky rrjet të sigurojë të ardhura/burime për funksionimin e tij,** pasi projekti SOLIDAR të përfundojë. Mënyrat për të siguruar të ardhura/burime, mund të jenë të ndryshme, që nga aplimike për fonde si grup informal, donacione nga biznese, dhe më e qëndrueshmja advokimi për tu njohur si një strukturë ad-hoc ose e qëndrueshmë e Pushtetit Lokal, për sa i përket sektorit të emergjencave, duke e pasuruar me të dhëna mbi vulnerabilitetet dhe rrisqet, informimin e komuniteteve, etj.

Qëndrueshmeria është e vështirë të arrihet nëse rrjetet CRN në nivel lokal nuk kanë një mbështetje nga ana e strukturave lokale, qofshin ato dhe me një marrveshje bashkëpunimi.

Aneks 1

Formati për mbledhjen e të dhënave mbi iniciativat e CRN-ve

Projekti: SOLIDAR – Bashkë në emergjencat shëndetësore

1. Informacion i përgjithshëm

Titulli i iniciativës/veprimtarisë: _____
Emri i grupit CRN: _____
Vendndodhja (bashkia/fshati): _____
Data/periudha e realizimit: _____

2. Përshkrimi i shkurtër

Përshkrim 6-7 rreshta mbi iniciativën:

3. Qëllimi dhe objektivat

Çfarë synonte iniciativa? Cilat ishin objektivat kryesore?

4. Grupi i synuar
Kush mori pjesë / kush përfitoi? Sa persona u përfshinë?

5. Aktivitetet kryesore
Çfarë aktivitetesh u zhvilluan konkretisht?

6. Rezultatet e arritura
Cilat ishin arritjet konkrete të veprimtarisë? Shembuj të ndryshimit të sjelljes, përfshirjes, bashkëpunimit, etj.

7. Përshtypje / citime nga pjesëmarrësit (opsionale)
Një ose dy fjali nga pjesëmarrësit mbi eksperiencën:

8. Elementi i “Best Practice”

Pse kjo iniciativë është një praktikë e mirë? Çfarë mund të mësojnë grupet e tjera nga kjo përvojë?

9. Foto / material mbështetës

Vendosni 1–2 foto ose materiale ilustruese